

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI  
TE KUFIZUAR

"EcoMetachrome" SHPK

Sot me date 29.10.2024 Anëtarët Themelues:

1. Z. Dritar Harapi , shtetas shqiptar, I datelindjes 24.04. 1967 lindur dhe banues ne Tiranë, identifikuar me karte identiteti me nr. 038231798 dhe numër personal G70424226M, madhor dhe me zotësi të plote per të vepruar;

2. Z. Adrian Kapllani , shtetas shqiptar, I datëlindjes 0.8.03.1969 lindur dhe banues në Durres, identifikuar me karte identiteti me nr. 034374498 dhe numër personal G90308207R, madhor dhe me zotësi të plote per të vepruar;

3. Z. Ejona Zaimaj, shtetas shqiptare, e datëlindjes 27.03.1984 lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. 037295358 dhe numër personal I45327068T, madhore dhe me zotësi të plote per të vepruar.

Të tre se bashku me vullnetin e tyre të lire dhe të plote, te shprehur nëpërmjet këtij Akt Themelimi dhe Statuti, rane dakort per krijimin e shoqerisë me përgjegjësi te kufizuar "EcoMetachrome" me kushtet e meposhtme.

KREU I

EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJAT3A, OBJEKTI

NENI 1

EMRI I SHOQERISE

1.1 Emri i shoqerisë me përgjegjesi te kufizuar është "EcoMetachrome" SHPK (me poshte e quajtur Shoqeria').

NENI 2

SELIA

2.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresen: Rruga "Vath Turja " ,Vrrine,Zona Kadastrale Nr 3339,Nr I Pasurise 1715,Volumi 5,Faqe 190,Ndertese 2 K, Kati 2, Ap 1, Xhafzotaj,Durres .

2.2 Asambleja e Pergjithshme mund të vendose mbi transferimin e selisë se Shoqerisë në nje adresë tjetër. Organi administrues i Shoqerise mund të themelojë ose mbylle degë dhe/ose zyra perfaqësimi,brenda apo jashtë Republikës së Shqiperise.

## NENI 3

### KOHEZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

## NENI 4

### OBJEKTI I SHOQERISE

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar në:




Shfrytëzim mineralësh (kromi) në sipërfaqe, hapje punimesh minerare të çdo lloji në sipërfaqe. Tregtim të të gjitha llojeve të mineraleve në Shqipëri dhe për eksport. Import-eksport të pajisjeve dhe makinerive për minierat, transport automobilistik etj. Tregtim të materialeve të ndërtimit, pajisjeve elektrike, mjeteve të nevojshme për to, mobiljeve (pajisje zyrash dhe orendi). Grumbullim dhe shitje skrapit. Prodhim e tregtim të materialeve të ndërtimit, lendeve të përpunuara dhe të papërpunuara, të lendeve drusore, plastike, duraluminit, xhami, hekuri, dhe të çdo produkti tjetër të lejuar nga ligji në fuqi. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitet në fushën e hotelerisë. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet nevojshme për financime në fushën e ndërtimit të projekteve të gjitha llojeve, veprave industriale e civile, pajisje e makineri të domosdoshme për to. Të blejë pasuri të patundshme, të kryejë veprime tregtare dhe financiare të nevojshme për të arritur qëllimin e saj, duke përfshirë (garanci, hipotekat dhe në favor të paleve të treta, duke përfshirë Shoqëritë, në këmbë të njëjtin objekt aktiviteti ose dhe objekt aktiviteti të ndryshëm. Të ushtrojë veprimtari private në fushën ndërtimore, punime dheu, punime eventuale murature e beton armepërshje dhe punime në tokë të germuar, prodhim materiale ndërtimi, ndërtime civile dhe ekonomike, ndërtime rrugore, ndërtime ura dhe vepra arti, ndërtime hidraulike e hidroteknike, vepra të vecanta e punime speciale, punime restaurimi, punime karpentierie, punime në impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, punime shërbimi, punime të sinjalizimit rrugor, impiante teknologjike dhe të vecanta dhe në fushën e projektimit, projektues, konstruktor, vepra hidraulike, rruge, ura dhe vepra arti, studim gjeologjik-inxhinierik-hidrologjik etj. Prodhim i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Ndërtimi i objekteve hidroteknike, fotovoltaike, etj, të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjisë që gjenden në natyrë dhe që janë të rinovueshme. Shitja e energjisë elektrike klienteve dhe blerja e energjisë elektrike nga operatore të ndryshëm private apo shtetëror brenda dhe jashtë vendit. Transmetimi i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfshin transmetimin ose interkoneksionin ndërkombëtar. Përdorimin e sistemeve të linjave, strukturave mbështetëse dhe pajisjesh transformuese për transmetimin e energjisë elektrike. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të marrë direkt ose indirekt interes në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti. Të kryejë Financime dhe Ofrimin e shërbimeve të konsulencës manaxheriale, financiare, IT, ligjore për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose të treta në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë. Zënie, grumbullim, përpunim dhe tregtim me shumicë e pakicë të prodhimeve të detit, brenda dhe jashtë vendit. Import, eksport, tregtim me

shumicë e pakicë i artikujve të ndryshëm industriale, makineri dhe pajisje për automjete të të gjitha llojeve. Agjensi doganore, transport me të tretët brenda dhe jashtë vendit. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme.

4.2 Per permbushjen e objektit të saj Shoqeria:

- a) Mund të marrë pjese dhe të jetë e interesuar ne shoqeri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejne aktivitete të njëjta, te ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesmarrëse;
- b) Mund te lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronare trualli apo objektesh.
- c) Mund të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kane të bëjnë, perfshire por pa u kufizuar në; ofrimin e garancive reale dhe/ose personale per detyrimet e veta dhe sé te tretëve, veprime me pasuri te paluajtshme, tregtare dhe cdo vepri tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose qe mundëson një perdorim me te mirë te strukturave dhe/se burimeve nëpermjet shoqerive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt shoqeria ka pjesmarrje apo kontrollin e tyre.

4.3 Shoqeria mund te veproje në Shqipëri dhe jashtë saj dhe te kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qellim te përmbushë ose te jetë i dobishëm per përmbushjen e objektit të saj.



KREU II  
KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I  
KAPITALIT

NENI 5

KAPITALI I SHOQERISE

5.1 Kapitali fillestar i shoqerise është 1,000 (njemijë) Lekë i ndarë ne 3 (tre) kuota. Kapitali i




Shoqerise nenshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortakët qe zotërojnë 100 % (njqind perqind) te kontributeve në kapitalin e shoqerise, perkatesisht:

1. Z. Dritar Harapi , shtetas shqiptar, I datelindjes 24.04. 1967 lindur dhe banues ne Tiranë, identifikuar me karte identiteti me nr. 038231798 dhe numër personal G70424226M , madhor dhe me zotësi të plote per të vepruar I cili zotron 37,5%.

2. Z. Adrian Kapllani , shtetas shqiptar, I datëlindjes 0.8.03.1969 lindur dhe banues në Durres, identifikuar me karte identiteti me nr. 034374498 dhe numër personal G90308207R, madhor dhe me zotësi të plote per të vepruar I cili zotron 37,5 %.

3. Zj. Ejona Zaimaj, shtetas shqiptare, e datëlindjes 27.03.1984 lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. 037295358 dhe numër personal I45327068T , madhore dhe me zotësi të plote per të vepruar I cili zotron 25%.

5.2 Ne rast zmadhimi apo zvogëhmi të kapitalit themeltar të Shoqerise ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesemarrjen qe zotëron secili në kapitalin e shoqerise.



## NENI 6

### KALIMI I KUOTAVE ME TRASHEGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT

6.1 Ne rast se një ortak apo bashkëzotërues i një kuote humb jetën, trashëgimtaret e tij do të jene te vetmet persona qe do t'i njihet titulli mbi kuotën nga Shoqeria; por asnje nga keto parashikime nuk cilron përgjegjsinë e trashëgimtareve nga cdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Ne rastin e vazhdimit të Shoqerisë me disa trashëgimtarë te ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtaret duhet te caktojnë nje perfaqesues të perbashket.

6.2 Personi që fiton te drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes Se jetes se falimentimit të një ortaku mund të zgjedhe të behet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotes në emër të nje personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës.

Nëse personi i mesiperm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqerine në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse personi i mësipërm zgjedh të kerkojë regjistrimin e kuotes ne emër të nje personi tjetër atëherë ai duhet ta kryeje ate nepermjet nje akti të vlefshëm të transferimit të kuotës.

6.3 Personi qe fiton të drejtat mbi nje kuotë si pasojë e humbjes se jetës ose falimentit të nje ortaku do te ketë të drejtat qe gezonte zotëruesi i kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesemarrjes ose te votes në cdo mbledhje te Asamblesë Se Pergjithshme, den në momentin e regjistrimit në regjistnin tregetar si zotërues i kuotes.

## NENI 7

### ZMADHIMI I KAPITALIT

7.1 Asambleja e përgjithshme mund te zmadhojë kapitalin e Shoqenise, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 te këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblese së Pergjithshme per zmadhimin e kapitalit do ti komunikohet me shkrim ortakëve që jane thirrur por nuk ishin te pranishëm ne mbledhjen e Asamblesë së Pergjithshme që vendosi per zmadhimin e kapitalit.

7.2 Ne rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën te nenshkruajne zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontnibute në natyre, ne përpjestim të drejte me kuotat qe zoterojne ne Shoqeri.

7.3 Ne rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nenshkrimit të pjeses së tyre, kapitali i panenshkruar mund të nenshkruset nga ortakët e tjerë. Ne këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojne

serish te drejtën per nënshkrimin e kapitalit ne perpjestlm te drejte me kuotat e pjesemarrjes ne Shoqeri.

## NENI 8 ZVOGLIMI I KAPITALIT

8.1 Asambleja e Pergjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Ne cdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund te zvogelohet nën kufirin e percaktuar me ligj.

8.2 Ortakët e përballojne zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjene tyre ne kapitalin e Shoqërisë.

## KREU III ASAMBLEJA E PERGJITHSHME NENI 9

### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME




9.1 Asambleja e Pergjithshme është Organi vendimmarrës I Shoqërisë. Asambleja e Pergjithshme vendos mbi të gjitha çështjet per të cHat është kompetente sipas ligjeve ne fuqi në Republikën e Shqiperise, sipas ketij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose cdo marreveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

9.2 Cdo ortak ka te drejtë të marrë pjese në mbledhjet e Asamblesë se Pergjithshme, të shprehe vullinetin e tij, si dhe te votojë ne perputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqeri.

9.3 Cdo ortak mund të perfaqesohet nga nje ortak tjetër ose nga një perfaqesues i deleguar me prokure me shkrim.

9.4 Ortaku nuk mund te delegoje të drejtën e votes per nje pjesë te kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht per pjesën e mbetur.

9.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund te mbahet brenda ose jashte territorit të Republikës se Shqiperise. Ortakët ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nepermjet mjeteve elektronike, përfshire telekonferencen (conference call, audio ose video) në perputhje me legjislacionin per tregëtarët dhe shoqërite tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblese Se Pergjithshme duhet te mbahet në vendin ku ndodhet Kryetari I saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te hartohet dhe te nënshkruhet procesverbali përkatës.



9.6 Asambleja e Pergjithshme mund të thirret nga Administratori/et ose nga ortaket që perfaqesojne te pakten 5% të Kapitalit te Shoqërise. Thirrja e mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme duhet te behet

nëpermjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, derguar secilit prej ortakeve ne adresat e njoftuara, të pakten 15 (pesembedhjetë) dite përpara dates së caktuar per mbledhjen e saj. Njoftimi duhet te permbaje rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

9.7 Asambleja e Pergjithshme do të mblidhet rregullisht, pavaresisht nga këto formalitete, në rast se te gjithë ortakët apo përfaqesuesit e tyre jane të pranishem dhe bien dakord per rendin e dites.




9.8 Mbledhjet e Asamblesë se Pergjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Pergjithshme cakton nje sekretar per cdo mbledhje midis personave te pranishëm.

9.9 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet të jene me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretare. Me kërkesë te ortakëve, vendimet duhet të përfshijne dhe deklaratat apo verejtjet e tyre.

9.10 Asambleja e Pergjithshme mblidhet të pakten një here në vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e Vitit Financiar.

9.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime te vlefshme vetem nëse marrin pjese ortakët me të drejte vote ose perfaqesuesit e tyre, që Si zotërojnë me shumë se 30% (tridhjetë per qind) te kapitaht të Shoqerise, përvec rasteve të parashikuara me poshte ne nenin 9.12. Ne rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e pare.

9.12 Asambleja e Pergjithshme vendos me votat pro të 3/4 të ortakëve pjesëmarrës apo të perfaqesuar që zotërojnë me shumë se 50% te kapitalit të Shoqerise per ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të Shoqerise, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.



## KREU IV

### ADMINISTRIMI I SHOQERISE

#### NENI 10

### ADMINISTRIMI I SHOQERISE

10.1 Shoqeria administrohet nga nje apo me shumë Administratorë të diet zgjidhen nga Asambleja e Pergjithshme per një periudhe prej 5 (pese) vjetesh. Administratori mund te rizgjidhet dhe shkarkohet ne cdo kohë nga Asambleja e Pergjithshme.




10.2 Administratori zoteron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqerise dhe mund të kryeje te gjitha aktet që konsideron të nevojshme per realizimin e objektit të Shoqerise, pervec atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblese së Pergjithshme apo organeve të tjera të Shoqerise.

10.3 Administratori vepron në perputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori është pergjegjes per veprimet e kryera në administrimin e Shoqerise. Administratori mund të delegoje persona të trete per kryerjen e veprimeve dhe akteve qe kane te bejne me administrimin e Shoqerise, duke mbajtur pergjegjesi per te gjitha veprimet e kryera nga te tretët e deleguar per administrimin e Shoqerisë.

10.4 Administratori do te veproje në cdo kohe vetëm në interesin me te mire të Shoqerise. Ne rast konflikti interesi, Administratori do te njoftoje menjehere ortakët si dhe do te heqe dore nga cdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit te interesit den ne marrjen e udhezimeve nga Asambleja e Pergjithshme.

10.5 Administratori i pare Shoqerise do te jetë:

- Zj. Ejona Zaimaj, shtetas shqiptare, e datëlindjes 27.03.1984 lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. 037295358 dhe numër personal I45327068T , madhore dhe me zotësi të plote per të vepruar e cili zotron 25% te kapitalit .



## NENI 11

### SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT

11.1 Asambleja e Pergjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqerise.

## NENI 12

### PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT

12.1 Detyra e Administratorit perfundon në rast Se:

- (a) I perfundon mandati;
- (b) shk o t nga Asambleja e Pergjithshme;
- (c) jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqerine;
- (d) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
- (e) mungon pa arsye në detyre për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Pergjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.

## KREU V

### KONTROLI FINANCIAR I SHOQERISE, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI

## NENI 13

### KONTROLI FINANCIAR

13.1 Kontrolli financiar i Shoqerise kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Asambleja e Pergjithshme do të emeroje një apo më shumë Ekspert Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

## NENI 14

### VITI FINANCIAR

14.1 Viti Financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

## NENI 15

### BILANCI VJETOR

15.1 Bilanci vjetor, Pasqyrat Financiare, Inventari, Raportet e Administratorit dhe të Ekspertit

Kontabël të Autorizuar (nëse janë emeruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori I paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogarite vjetore.

15.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme Brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar

## NENI 16

### DIVIDENTI

16.1 Past t jone përmbushur kërkesat e percaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë të Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

16.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendet duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjitha dividendet do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumën e paguara mbi kuotat gjatë çdo pjesë ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividendi.




## KREU VI

PRISHJA DHE LIKUJDIMI, LIGJI I ZBATUESHËM, ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

## NENI 17

### PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

17.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.



NENI 18




LIGJI I ZBATUESHEM

18.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjisllacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 19

ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE



19.7 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtareve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.



ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

ARTAN HARAPI

ADRIAN HARCAJI



Gjergj Lili

